LIGJ
Nr.9830, datë 12.11.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT RRUGOR KALIMASH – REXHEPAJ, PJESË E PROJEKTIT RRUGOR DURRËS-MORINË" DHE "MARRËVESHJES SË AGJENCISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR KËTË PROJEKT, QË I BASHKËLIDHET MARRËVESHJES INSTISNA'A"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për ndërtimin e seksionit rrugor Kalimash - Rexhepaj, pjesë e projektit rrugor Durrës-Morinë" dhe "Marrëveshjes së Agjencisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për këtë projekt, që i bashkëlidhet Marrëveshjes Instisna'a".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5522, datë 20.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE E NDËRMJETME (ISTISNA'A)
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM NË LIDHJE ME NDËRTIMIN E SEKSIONIT NGA KALIMASH, NË REXHEPAJ, SI PJESË E PROJEKTIT TË RRUGËS DURRËS-MORINË, TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kjo Marrëveshje lidhet më ___ / ___ / _____ 1428H, që i korrespondon datës ___ / ___ / _____2007G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu quajtur si "Agjenti") dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu quajtur si "IDB").

Ndërsa,

1. IDB-ja ka rënë dakord në përputhje me Marrëveshjen e kësaj date (në vazhdim e quajtur si "Marrëveshja e Istisnas") për të ndërtuar për Agjentin seksionin nga Kalimashi në Rexhepaj të projektit të rrugës Durrës–Morinë, të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje (këtu e quajtur si "Rruga") për përdorim në projektin e përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje;

2. IDB-ja ka rënë dakord me Agjentin që Agjenti, në emër të IDB-së, të përfundojë kontratën me Kontraktuesin dhe të përfundojë ndërtimin e rrugës;

3. Palët kanë rënë dakord që agjencia zbatuese për vënien në jetë të projektit, në emër të Agjentit, do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (GRD) në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë. Palët kanë rënë gjithashtu dakord që

agjencia zbatuese do të zbatojë projektin përmes një njësie për zbatimin e projektit (PIU),

tashmë si rrjedhim, IDB-ja dhe Agjenti bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Përkufizime, interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveçse kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimin që shfaqet përbri secilit prej tyre, si më poshtë:

Shuma e miratuar:	Shuma e miratuar nga IDB-ja për ndërtimin e rrugës.
Rruga:	Rruga e përshkruar në shtojcën I këtu.
Kostoja e kapitalit:	Kostoja totale e ndërtimit të rrugës, e cila do të përfshijë çmimin e kontratës, tarifat e këshilltarit dhe të gjitha kostot apo shpenzimet e tjera që i shkaktohen IDB-së në apo në lidhje me ndërtimin e rrugës dhe mbikëqyrjen e ndërtimit.
Marrëveshja e këshillimit:	Marrëveshja për mbikëqyrjen e ndërtimit të rrugës e arritur ndërmjet Agjentit dhe këshilltarit, në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.
Këshilltari:	Firma këshilluese apo këshilltari individual që do të caktohet, në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.
Çmimi i kontratës:	Çmimi i pagueshëm ndaj Kontraktuesit për ndërtimin e rrugës.
Kontrata:	Kontrata për ndërtimin e rrugës e përfunduar, në emër të IDB-së, nga Agjenti me Kontraktuesin.
Kontraktuesi:	Kontraktuesi të cilit do t'i besohet ndërtimi i rrugës.
Data e disbursimit të parë:	Data në të cilën IDB-ja bën disbursimin e parë, sipas kontratës apo ndaj këshilltarit, cilado që të jetë më e hershme.
Data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes:	Data në të cilën IDB-ja e deklaron këtë Marrëveshje efektive, në përputhje me nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.
Certifikata përfundimtare e pranimit:	Certifikata e lëshuar nga këshilltari, në përputhje me kushtet e kontratës, e cila përcakton se ndërtimi i rrugës është përfunduar nga Kontraktuesi në mënyrë të kënaqshme.
Periudha e zhvillimit:	Periudha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe mbaron tridhjetë e gjashtë (36) muaj më pas.
Certifikata e pranimit paraprak:	Certifikata e lëshuar nga këshilltari, sipas kontratës, dhe e kundërfirmosur nga Agjenti, e cila përcakton pranimin paraprak të rrugës nga Agjenti, siç tregohet në kontratë.
Projekti:	Projekti i përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje.
Taksat:	Çfarëdo takse, tarife, detyrimi apo barre tjetër e një natyre të ngjashme (duke përfshirë këtu pa kufizim çdo gjobë të pagueshme në lidhje me cilëndo mosarritje për ta paguar apo vonesë në pagimin e cilësdo prej tarifave apo pagesave të përmendura më lart).

1.2 Në këtë Marrëveshje:

a) Përveçse, kur konteksti kërkon ndryshe, fjalët që shprehen në njëjës përfshijnë edhe numrin shumës dhe anasjellas, fjalët që shprehin persona përfshijnë edhe shoqëritë dhe ortakëritë dhe referimet në një shtojcë, bashkëlidhje, nen apo ndarje të veçantë janë referime tek ajo shtojcë, bashkëlidhje, nen apo seksion i kësaj Marrëveshjeje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Istisna'a-s dhe që nuk janë përcaktuar këtu do të kenë të njëjtin kuptim siç është dhënë në Marrëveshjen e Istisna'a-s.

c) Kryeradhët e neneve dhe të seksioneve janë futur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të përdoren për të përkufizuar, interpretuar apo kufizuar cilëndo nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Preambula dhe shtojcat, pjesë e Marrëveshjes

Preambula dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë përbërëse e saj.

Neni 3
Zgjedhja e Kontraktuesit

3.1 Palët kanë rënë dakord në këtë Marrëveshje që Agjenti, pas këshillimeve me IDB-në dhe në përputhje me procedurat e prokurimit të IDB-së, si dhe pas miratimit të saj, do të zgjedhë një kontraktues nga një vend anëtar për të ndërtuar rrugën duke u bazuar në sa vijon:

i) paketa e punëve civile përfshin punime rrugore për ngritjen e urave dhe strukturat për ndërtimin e urave do të blihen përmes një tenderi konkurrues ndërkombëtar (ICB), pjesëmarrja në të cilin është e kufizuar vetëm te vendet anëtare të IDB-së sipas procedurave të prokurimit të IDB-së;

ii) shërbimet e këshillimit do të blihen përmes përzgjedhjes së këshilltarëve nga vendet anëtare të IDB-së;

iii) blerja e pajisjeve dhe mjeteve për njësinë e zbatimit të projektit do të bëhet përmes blerjeve në vend; dhe

iv) shërbimet e një kontrollori financiar të kontrolluar vendor do të blihen përmes një përzgjedhjeje të shoqërive vendore, në përputhje me politikat dhe procedurat e IDB-së.

3.2 Agjenti, në emër të IDB-së, do të negociojë dhe përfundojë një kontratë me Kontraktuesin sipas sa vijon:

a) për kushtet dhe afatet e kontratës do të bihet dakord ndërmjet IDB-së dhe Agjentit;

b) çmimi i kontratës nuk do të kalojë shumën 30 000 000 USD (tridhjetë milionë dollarë amerikanë);

c) periudha për përfundimin e ndërtimit të rrugës, sipas kontratës, nuk do t'i kalojë tridhjetë e gjashtë (36) muaj nga data e disbursimit të parë ndaj Kontraktuesit;

d) specifikimet e rrugës, sipas kontratës, do të jenë si ato që përshkruhen shkurtimisht në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje dhe siç tregohen më me hollësi në kontratë;

e) pas përfundimit, rruga do të merret në dorëzim drejtpërdrejt nga Agjenti;

f) miratimi i shkruar i IDB-së për afatet dhe kushtet e kontratës së negociuar do të përftohet përpara përfundimit të kontratës nga Agjenti;

g) kontrata do të përcaktojë se Kontraktuesi do të blejë edhe të gjithë sigurimin e rrezikut të Kontraktuesit, sipas rregullave në tregti dhe shumat e sigurimit do t'i paguhen IDB-së në dollarë amerikanë.

Neni 4
Ndryshimet dhe shtesat e kontratës

Agjenti, pa miratimin paraprak me shkrim të IDB-së, nuk do të bëjë asnjë ndryshim, shtesë apo rregullim të kontratës, i cili mund (a) të rezultojë në rritje të çmimit të kontratës, ose (b) të rezultojë në një zgjatje të datës së përfundimit, ose (c) të rezultojë në një ndryshim të specifikimit, ose (d) të mos jetë në përputhje me praktikën e zakonshme pozitive.

Neni 5
Caktimi i një këshilltari

5.1 Me qëllim që të ndihmohet Agjenti në mbikëqyrjen e kontratës, vetë Agjenti, pas këshillimit me IDB-në, dhe në përputhje me procedurat e IDB-së, do të përzgjedhë dhe të marrë nën kontratë shërbimet e një këshilltari të specializuar nga një listë e zgjedhur këshilltarësh me reputacion.

5.2 Afatet dhe kushtet e kontratës së këshilltarit do të bihen dakord me shkrim, ndërmjet Agjentit dhe IDB-së përpara ftesës për propozime nga këshilltarët e zgjedhur.

5.3 Agjenti do t'i bashkëngjitet IDB-së në negociatat me këshilltarin e përzgjedhur, rezultati i të cilave do t'i nënshtrohet miratimit përfundimtar të Agjentit dhe të IDB-së.

5.4 Agjenti merr përsipër që në mbikëqyrjen e tij të kontratës, ai do të ushtrojë standardin më të lartë të përpikmërisë dhe kujdesit në vëzhgimin, me ndihmesën e këshilltarit, e kryerjes korrekte dhe të saktë nga ana e Kontraktuesit të detyrimeve të tij, sipas kontratës, me synimin për të siguruar që rruga do të ndërtohet në përputhje me specifikimet brenda kohës dhe për çmimin e përcaktuar në

kontratë.

5.5 Pa cenuar zbatimin e përgjithshëm të seksionit 5.4 të kësaj Marrëveshjeje, Agjenti do të jetë i detyruar që:

a) të këshillojë IDB-në, sa më shpejt që të jetë, në mënyrë të arsyeshme të praktikueshme, mbi çdo vonesë apo vonesë të parashikuar në përfundimin e ndërtimit të rrugës me të gjitha hollësitë përkatëse;

b) të merret me të gjitha çështjet administrative dhe normative në lidhje me ndërtimin e rrugës, në përputhje me ligjet përkatëse në Republikën e Shqipërisë;

c) të nënshkruajë certifikatën e pranimit paraprak dhe certifikatën e pranimit përfundimtar, nëse ai është i kënaqur se puna në fazën përkatëse është zbatuar në përputhje me kontratën, duke përfshirë këtu edhe specifikimet.

5.6 Nëse duke shkelur nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje, Agjenti jep udhëzime për Kontraktuesin si rrjedhojë e të cilave ka një rritje të çmimit të kontratës apo, nëse IDB-ja bëhet përgjegjëse ndaj cilësdo palë për çfarëdo pretendim, humbje, dëmtim apo shpenzim, atëherë Agjenti është dakord që të përballojë rritjen në çmimin e kontratës ose, siç mund të jetë rasti, për të dëmshpërblyer IDB-në për çfarëdo pretendim, humbje, dëmtim apo shpenzim të tillë.

5.7 Është rënë dakord që Agjenti të sigurojë një numër të tillë të personelit të tij, siç do të ishte e nevojshme, për të kryer detyrat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas kontratës.

5.8 Agjenti nuk do të ketë të drejtë për asnjë dëmshpërblim apo pagesë tjetër nga IDB-ja në lidhje me apo që rrjedh nga caktimi i Agjentit si mbikëqyrës i IDB-së sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Disbursimi i shumës së miratuar

6.1 IDB-ja do të disbursojë shumën e miratuar në mënyrën e përcaktuar në kontratë dhe në përputhje me procedurat e disbursimit të IDB-së.

6.2 Pa cenuar zbatimin e përgjithshëm të seksionit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje, Agjenti:

a) do të sigurojë një kopje të Marrëveshjes së nënshkruar të këshilltarit, kur të paraqesë aplikimin për disbursimin e parë në favor të këshilltarit;

b) do të sigurojë një kopje të firmosur të kontratës, (nëse nuk e ka paraqitur më parë) dhe kopje të policës së sigurimit të referuar në seksionin 3.2 (g) të kësaj Marrëveshjeje.

6.3 IDB-ja nuk do të jetë e detyruar të bëjë asnjë disbursim, nëse aplikimi për disbursim nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje apo nëse dokumentet e paraqitura nga Agjenti janë të paplota apo ndryshe të pamjaftueshme. Agjenti do të jetë përgjegjës për çdo vonesë në disbursim, nëse një vonesë e tillë është shkaktuar nga aplikimi që nuk ishte në përputhje me këtë Marrëveshje apo për shkak të pamjaftueshmërisë apo mospërputhjes në dokumentet e kërkuara.

Neni 7

Marrja në dorëzim e rrugës

7.1 Është rënë dakord që kontrata do të parashikojë për marrjen në dorëzim të rrugës pas përfundimit drejtpërdrejt nga Agjenti. Është rënë gjithashtu dakord që IDB-ja nuk do të jetë në asnjë rast përgjegjëse përpara Agjentit për çfarëdo humbje që vjen si rrjedhojë e vonesave në marrjen në dorëzim të rrugës.

7.2 Për shmangien e dyshimeve është rënë dakord që, nëse pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, Agjenti refuzon të marrë në dorëzim rrugën nga Kontraktuesi për çfarëdolloj arsyeje, Agjenti do t'i paguajë një dëmshpërblim IDB-së për çfarëdo kostosh, shpenzimesh apo humbjesh që kanë ardhur si rrjedhojë.

Neni 8

Përfaqësimet dhe garancitë

Agjenti përfaqëson dhe garanton se:

1. ka kompetencën për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për t'i përmbushur detyrimet e tij të marra këtu, si dhe se të gjitha veprimet që kërkohen për të autorizuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushjen nga Agjenti të detyrimeve të tij, janë ndërmarrë siç duhet;

2. detyrimet e shprehura e për t'u marrë përsipër nga Agjenti në këtë Marrëveshje janë detyrime të vlefshme dhe të ligjshme, që janë të detyrueshme për Agjentin, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

3. zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga Agjenti i detyrimeve të tij, sipas kësaj kontrate, nuk përbëjnë e nuk do të sjellin si rrjedhim asnjë shkelje të asnjë Marrëveshjeje, traktati apo ligji;

4. të gjitha aktet, kushtet dhe gjërat (duke përfshirë këtu shkëmbimin e miratimeve të kontrollit) të kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë do të bëhen, plotësohen dhe kryhen me qëllim që:

i) të mundësohet Agjenti që ligjërisht të hyjë dhe të përmbushë detyrime që ai shpreh se merr përsipër në këtë Marrëveshje;

ii) të sigurohet se detyrimet e shprehura për t'u marrë përsipër nga ai në këtë Marrëveshje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

iii) kjo Marrëveshje të bëhet e pranueshme në praktikë në Republikën e Shqipërisë pa qenë nevoja që të bëhen, plotësohen apo përmbushen hapa apo formalitete të tjera në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë;

5. nuk është ndërmarrë apo kërcënuar se do të ndërmerret asnjë veprim apo procedim administrativ nga apo përpara cilësdo agjenci apo gjykatë e që mund të ketë efekte materiale të kundërta mbi kushtet financiare të Agjentit;

6. sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi në atë datë, pretendimet e IDB-së përkundrejt Agjentit, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të cilësohen të paktën si në *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për çfarëdo borxhi të Agjentit.

Neni 9
Dëmshpërblimet

9.1 Agjenti merr këtu përsipër që të dëmshpërblejë IDB-në, mbi një bazë të llogaritur neto pas taksave (në shkallën e zbatueshme vendore dhe të huaj të taksave mbi të ardhurat) përkundrejt tyre, si dhe bie dakord që të mbrojë, ruajë dhe mbajë të padëmtuar IDB-në nga cilado dhe të gjitha – detyrimet, tarifat, përgjegjësitë, humbjet, dëmtimet, dënimet, pretendimet, veprimet, gjykimet dhe shpenzimet, duke përfshirë këtu tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore (duke përfshirë tarifa dhe shpenzime të tilla ligjore që vijnë në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje), të çdo lloji dhe natyre qofshin, të vëna mbi apo të ardhura nga, apo të nisura përkundrejt IDB-së e që rrjedhin nga:

a) Pronësia, posedimi, përdorimi, dokumentimi, heqja, kthimi apo zbatime apo dispozita të tjera, sipas kontratës apo marrëveshjes së këshillimit duke përfshirë të tilla siç mund të vijnë nga:

i) çdo lloj humbjeje apo dëmtimi ndaj cilësdo pronësi apo vdekje, apo plagosje e cilitdo person;

ii) mangësi patente apo mangësi të tjera të paevidentueshme në rrugë;

iii) çdo lloj pretendimesh të ngritura mbi përgjegjësinë e kufizuar në dëm apo të tjera;

iv) çdo lloj pretendimesh të bazuara mbi dhunime të të drejtave të autorit, atyre të pronësisë industriale apo të markave tregtare të patentave;

v) çdo lloj të drejtash që bazohen në përgjegjësitë që rrjedhin nga ligjet e zbatueshme mjedisore apo nga miratimet mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me të drejtat mbi rrugën apo mbi tokën mbi të cilën ajo ndërtohet;

vii) çdo pretendim apo mosmarrëveshje që lidhet me kontratën apo çdo letërkredit të nxjerrë në vijim të saj ose në lidhje me marrëveshjen e këshilltarit.

b) Ndodhja e çfarëdo mospagese apo çfarëdo mosarritjeje tjetër nga ana e Agjentit apo e Kontraktuesit për të përmbushur apo plotësuar me cilindo afat të kësaj Marrëveshjeje, apo çdo dokument, marrëveshje apo kontratë në të cilën është hyrë në lidhje me të, apo ndryshe në lidhje me rrugën, por duke përjashtuar këtu cilindo pretendim të bazuar mbi mosarritjen nga ana e IDB-së që të përmbushë detyrimet e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, apo çdo dokumenti, marrëveshjeje apo kontrate në të cilën është hyrë nga IDB-ja në lidhje me të apo në lidhje me rrugën në ndonjë mënyrë tjetër;

c) Cilatdo pretendime, barra, interesa sigurimi dhe çështje apo procese gjyqësore në lidhje me të drejtat apo interesat mbi rrugën apo tokën mbi të cilën ajo ndërtohet.

9.2 Agjenti do t'i japë IDB-së njoftim të menjëhershëm mbi çdo ndodhi apo kusht të njohur

për Agjentin si pasojë e të cilit IDB-ja është apo ka në mënyrë të arsyeshme mundësi të ketë të drejtë për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi i parashikuar në seksionin 9.1 do të zbatohet specifikisht dhe do të përfshijë pretendimet apo kërkesat e ngritura nga apo në emër të të punësuarve të Agjentit dhe Agjenti në mënyrë të shprehur heq dorë, përkundrejt IDB-së, nga çdo imunitet për të cilin Agjenti do të kishte pasur normalisht të drejtë ta gëzonte sipas ligjeve të zbatueshme; dhe Agjenti do ta rimbursojë IDB-në menjëherë, sipas kërkesës së IDB-së, (sidoqoftë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga një kërkesë e tillë) për shumat e shpenzuara nga ai në lidhje me cilëndo nga të mësipërmet apo t'i paguajë këto shuma drejtpërdrejt. Agjenti do t'i shmanget të drejtave të IDB-së në çdo çështje në lidhje me të cilën Agjenti e ka rimbursuar tashmë IDB-në për shuma të shpenzuara nga ai, apo ka paguar drejtpërdrejt shuma të tilla në përputhje me seksionin 9.1. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim apo procedim kundër IDB-së në lidhje me cilindo pretendim të padëmshpërblyer, IDB-ja do ta njoftojë përkatësisht Agjentin, pas marrjes së njoftimit mbi fillimin e një veprimi apo procedimi të tillë, duke i bashkëngjitur një kopje të të gjitha dokumenteve që i kanë ardhur IDB-së. Agjenti mund të mbrohet dhe ta kundërshtojë një kërkesë apo procedim të tillë me shpenzimet e tij dhe mbi kërkesën e IDB-së, apo të bëjë që kjo mbrojtje të bëhet nga një përfaqësues i zgjedhur nga Agjenti dhe në mënyrë të arsyeshme i kënaqshëm për IDB-në. Në rast të çfarëdo mosarritjeje nga Agjenti për ta bërë një gjë të tillë, Agjenti do t'i paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të mbrojtjes ligjore) që i kanë ardhur IDB-së në lidhje me një veprim apo procedim të tillë.

Neni 10
Raportet

Agjenti merr përsipër t'i paraqesë IDB-së raportet si vijon:

a) Brenda tre muajve pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe në vijim, çdo tre muaj të tjerë, një raport mbi përparimin e bërë dhe zbatimin e kontratës në një mënyrë të tillë siç mund të kërkojë kohë pas kohe veçanërisht IDB-ja;

b) 90 ditë pas përfundimit të çdo viti financiar, një raport mbi kushtet financiare të Agjentit dhe rezultatet e operacioneve të tij, gjatë vitit financiar të sapopërfunduar së bashku me deklaratën e llogarive që i janë nënshtruar kontrollit financiar, duke përfshirë këtu pasqyrën e bilancit dhe llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve për vitin financiar të sapopërfunduar;

c) Menjëherë pas lëshimit të certifikatës së pranimit përfundimtar, por jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të një certifikate të tillë, të paraqesë një raport përmbyllës për një qëllim të tillë dhe me hollësi, të tilla, siç IDB-ja mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme mbi ndërtimin dhe operimin fillestar të rrugës;

d) Çdo raport apo informacion tjetër të cilin IDB-ja mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme, kohë pas kohe.

Neni 11
Heqja dorë

Mosarritja e IDB-së që të ushtrojë apo të mbrojë ndonjë nga të drejtat e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, apo vonesa e saj për të njëjtën gjë, apo mosarritja e saj për të ushtruar apo mbrojtur çfarëdo lloj dëmshpërblimi që ajo mund të ketë të drejtë përkundrejt Agjentit, apo vonesa e saj për të njëjtën gjë, nuk do të cenojë një të drejtë apo dëmshpërblim të tillë dhe nuk do të quhet si heqje dorë nga një e drejtë apo dëmshpërblim i tillë.

Neni 12
Data e hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes së Istisna'a-s.

Neni 13
Ligji rregullues – zgjidhja e mosmarrëveshjeve

13.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga, si edhe do të interpretohet në përputhje me të drejtën islame (Islamic Shariah).

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim nga Palë të

tilla kundër Palës tjetër që rrjedh nga Marrëveshja, të cilat nuk janë mundur të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, data e njoftimit nga njëra Palë ndaj Palës tjetër do t'i paraqitet arbitrimit, përmes një Gjykate Arbitrazhi siç parashikohet në vijim:

a) Palët në këtë arbitrim do të jenë IDB-ja nga njëra anë dhe Agjenti nga ana tjetër.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë arbitrazhi të emëruar si vijon:

Një arbitër do të emërohet nga IDB-ja, gjyqtari i dytë i arbitrazhit do të emërohet nga Agjenti dhe gjyqtar i tretë i arbitrazhit (në vijim referuar si gjyqtari) do të emërohet me marrëveshje të Palëve ose, nëse ato nuk do të bien dakord, nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Konferencës Islamike (OIC). Gjyqtari do të jetë një jurist i specializuar në financat ndërkombëtare ose një bankier me njohuri në transaksionet financiare islamike. Nëse cilado nga Palët nuk arrin të emërojë një gjyqtar arbitrazhi, një gjyqtar i tillë arbitrazhi do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OIC. Në rast se cilido nga gjyqtarët e arbitrazhit të caktuar në përputhje me këtë seksion jep dorëheqjen, vdes apo bëhet i pazotë për të vepruar, një gjyqtar pasardhës arbitrazhi do të emërohet në të njëjtën mënyrë siç përshkruhet këtu për emërimin e gjyqtarit fillestar të arbitrazhit dhe një pasardhës i tillë do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e gjyqtarit fillestar të arbitrazhit.

c) Një procedim arbitrimi mund të fillohet sipas këtij seksioni pas njoftimit nga Pala që e ngre këtë procedim në drejtim të Palës tjetër. Një njoftim i tillë do të përmbajë një deklaratë që përcakton natyrën e mosmarrëveshjes apo të pretendimit që do të paraqitet për arbitrazh, natyrën e ndihmës që kërkohet, emrin e gjyqtarit të arbitrazhit të caktuar nga Pala që ngre procedimin dhe emrin e një gjyqtari të propozuar. Brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së një njoftimi të tillë, Pala tjetër do të njoftojë Palën që ngriti procedimin për emrin e gjyqtarit të arbitrazhit të caktuar nga kjo Palë dhe rënien dakord apo jo të kësaj Pale për emërimin e gjyqtarit të propozuar.

d) Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas dhënies së një njoftimi të tillë për fillimin e procedimeve të arbitrazhit, Palët nuk do të kenë rënë dakord për një gjyqtar ose Pala së cilës i është dhënë njoftim për arbitrazhin nuk arrin të emërojë një gjyqtar arbitrazhi, cilado Palë mund të kërkojë emërimin e gjyqtarit të dytë të arbitrazhit ose të gjyqtarit, (si të jetë rasti) siç parashikohet në paragrafin (b) të këtij seksioni.

e) Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në një kohë dhe vend të tillë siç do të jetë përcaktuar nga gjyqtari. Si rrjedhim, Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë se kur dhe ku do të mblidhet.

f) Duke iu nënshtruar dispozitave të këtij seksioni dhe, përveç rasteve kur Palët kanë rënë dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë mbi të gjitha çështjet që lidhen me kompetencën e saj dhe do të përcaktojë procedurat e veta. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me shumicë votash.

g) Gjykata e Arbitrazhit do t'u japë të gjitha Palëve mundësinë e një dëgjimi të drejtë dhe do të japë vlerësimin e saj me shkrim. Një vlerësim i nënshkruar nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit përbën vlerësim të kësaj Gjykate. Një kopje e nënshkruar e vlerësimit do t'i përcillet secilës nga Palët. Çdo vlerësim i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët e kësaj Marrëveshjeje. Secila Palë do t'i bindet dhe do të përmbushë çdo vlerësim të tillë të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit, në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

h) Palët do të caktojnë shumën e shpërblimit të arbitrave dhe personave të tjerë të tillë, siç do të kërkohet për kryerjen e procedimeve të arbitrimit. Nëse Palët nuk do të bien dakord për një shumë të tillë përpara sesa Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë një shumë të tillë si të jetë e përshtatshme sipas rrethanave. IDB-ja dhe Agjenti do të përcaktojnë secila shpenzimet e tyre në procedimet e arbitrazhit. Kostot e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen dhe do të përballohen njëlloj nga IDB-ja dhe nga Agjenti. Çdo çështje, lidhur me ndarjen e kostove të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedura për pagesën e kostove të tilla, do të përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

i) Dispozitat për arbitrazhin të përcaktuara në këtë seksion do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje apo çdo pretendim nga një Palë e tillë përkundrejt Palës tjetër që rrjedh nga kjo Marrëveshje.

j) Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve, pasi kopjet e vlerësimeve t'u jenë dërguar Palëve, ky vlerësim nuk do të jetë zbatuar, secila Palë mund ta fillojë një gjykim ose procedime për zbatimin e vendimit në ndonjë gjykatë me juridiksion kompetent kundër Palës tjetër, mund ta zbatojë këtë vendim përmes ekzekutimit ose mund të ndjekë çfarëdo rruge tjetër të përshtatshme për dëmshpërblim kundër kësaj Pale tjetër për zbatimin e vendimit apo dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

k) Dërgimi i çfarëdo njoftimi apo procesi në lidhje me çfarëdo procedimesh sipas këtij

seksioni apo në lidhje me çdo procedim tjetër për të zbatuar çdo vendim të dhënë në zbatim të këtij seksioni mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje. Palët në këtë Marrëveshje heqin dorë nga ndonjë dhe të gjitha kërkesat e tjera të veçanta për dërgimin e çfarëdo njoftimi apo procesi të tillë.

Neni 14
Njoftimet

14.1 Çdo njoftim apo kërkesë për t'u dhënë apo për t'u bërë nga një Palë ndaj tjetrës, sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të, do të jetë me shkrim dhe mund të jepet me teleks ose me letër. Një njoftim apo kërkesë e tillë do të vlerësohet se është dhënë në mënyrën e duhur apo është bërë siç duhet, kur të jetë dorëzuar në dorë ose përmes postës apo të jetë dërguar me teleks apo telefaks ndaj Palës tjetër në adresën e specifikuar në seksionin 14.2 të kësaj Marrëveshjeje apo në cilëndo adresë tjetër, siç mund ta përcaktojë duke ia njoftuar këtë Palës tjetër.

14.2 Për qëllimet e seksionit 14.1 të kësaj Marrëveshjeje, Palët kanë dhënë adresat e tyre, si vijon:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Ministri i Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1
Tiranë, Albania
Tel: ++ (355-4) 228-405
Faks: + +(355- 4) 228-494

Për Bankën Islamike për Zhvillim
P.O. BOX: 5925,
Jeddah – 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601137 ISBD SJ
Telegraf: BANKISLAMI JEDDAH
Tel: +699 2 6361400
Faks: + 966 2 6366 871

FAQJA E ZBATIMIT

Në dëshmi të sa më sipër, Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përmendur në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCA I
PËRSHKRIMI I RRUGËS

Rruga, që konsiston në një variant me 4 korsi 2X (2X3.75 metra + 2X 1.5 metra) duke përdorur barriera New Jersey, fillon pranë liqenit të vogël në Kolsh dhe zbret përmes kodrave të jugut të zonës, duke u shmangur nga ura ekzistuese në Kolsh dhe duke kërkuar rrjedhimisht ndërtimin e një ure-rrugë të re me gjatësi 240 metra. Më pas rruga vazhdon përgjatë kodrës derisa arrin në fshatin Myc. Më pas, kalohet lumi me anë të urës me gjatësi 240 metra dhe duke qenë në 45 metra lartësi. Në kilometrin 5+400 ka përsëri një urë me gjatësi 120 metra. Rruga përfundon te linja ekzistuese e asfaltit. Urat e sipërme janë propozuar që të kenë gjerësi prej 30 ose 40 metrash. Strukturat kryesore janë 10 elemente lidhëse me një gjatësi të përgjithshme prej 800 metrash.

SHTOJCA II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Synimi kryesor i projektit është që të sigurojë një rrjedhë të pandërprerë të trafikut, të pakësojë kostot e operimit të automjeteve dhe aksidentet rrugore, të kursejë kohën e udhëtimit dhe të sjellë një përmirësim të përgjithshëm ekonomik në zonën e projektit, përmes një mundësie të rritur hyrjeje dhe

lëvizshmërie më të madhe për në zonat rurale. Projekti, gjithashtu do të përshpejtojë hyrjen drejt zonave bregdetare dhe në terrenin malor mbresëlënës, si dhe në zonat fshatare përtej Kukësit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me vendin fqinjë, Kosovën. Projekti përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. Punimet civile

(Punimet civile për seksionin e rrugës Kalimash – Rexhepaj (5.6 kilometra), rrugë me katër korsi (secila 3.75 metra e gjerë) dhe me dy bankina (secila 1,5 metra e gjerë);

2. Shërbimet e këshillimit (rishikim i projektit të detajuar dhe supervizionit);
3. Njësia e menaxhimit të projektit (PMU);
4. Kontrolli financiar;
5. Seminari i fillimit dhe vizita familjarizimi në selinë e IDB-së;
6. Kontingjencat fizike dhe të çmimeve.

BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (Stema)
JEDDAH – ARABIA SAUDITE

FAKS

Nr: REF 41/14/ALB'2242 Datë 29 maj 2007

Për Shkëlqesinë e tij. z.Fatos Ibrahimi
zv. Guvernator
Banka e Shqipërisë
(Guvernatori Alternativ, IDB)
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Faks: (355-4) 223558

Për dijeni: z.Stavri Ristani
zv. Ministër
Ministria e Punëve Publike
Transportit dhe Telekomunikacionit
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Faks: (355-4) 232389

Për dijeni: z.Durim Kraja
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Faks: (355-4) 223119

Për dijeni: z.Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Faks: (355-4) 228494

Lënda: PROPOZIMI I NDËRTIMIT TË PROJEKTIT RRUGOR DURRËS – MORINË (SEGMENTI KALIMASH – REXHEPAJ), REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shkëlqesi,

Assalamu Alaikum Ëarahmatullahi Ëabarakatuh

Unë do të doja t'i referohesha faksit nr: L6F3/6 të datës 21 maj 2007, marrë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që konfirmon pranimin e termave dhe kushteve të financimit të IDB-së për Qeverinë e Shqipërisë për projektin e sipërpërmendur. Kam kënaqësinë të informoj

Shkëlqesinë Tuaj se Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të IDB-së, në mbledhjen e tij të 245-të të datës 27 maj 2007, miratoi një propozim financimi të Qeverisë së Shqipërisë për ndërtimin e projektit rrugor Durrës – Morinë (Segmenti Kalimash – Rexhepaj – Loti nr.8), duke kombinuar Istisna'a dhe dhënien e kredisë në termat dhe kushtet e mëposhtme:

Istisna'a

i) IDB-ja do të mundësojë për Qeverinë e Shqipërisë (Blerësi/agjenti) një shumë prej 30 milionësh USD (përafërsisht 20 milionë ID) për ndërtimin e projektit rrugor Durrës-Morinë (Segmenti Kalimash – Rexhepaj);

ii) IDB-ja do të ndërtojë rrugën për Blerësin dhe agjencia ekzekutuese për projektin do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPR). Marrëveshja Istisna'a do të jetë ndërmjet IDB-së dhe Qeverisë së Shqipërisë (Blerësi/Agjenti);

iii) Toka për projektin duhet të jetë e lirë nga çdo lloj pengese dhe Blerësi/Agjenti ka autoritet të ligjshëm dhe të vlefshëm dhe të përhershëm mbi të;

iv) Istisna'a dhe Marrëveshja e ndërmjetme midis Blerësit/Agjentit duhet të firmosen brenda 6 muajve nga data e miratimit të projektit nga IDB-ja. Nëse Marrëveshjet nuk janë firmosur brenda periudhës së thënë më sipër, projekti do t'i nënshtrohet anulimit;

v) Me nënshkrimin e Marrëveshjes, kushtet e efektivitetit duhet të përmbushen brenda 6 muajve, duke dhënë të gjitha dokumentet dhe informacionet sipas kërkesave të Marrëveshjes. Nëse Marrëveshja mbetet joefektive pas 6 muajve nga data e firmosjes, IDB-ja rezervon të drejtën ta përfundojë Marrëveshjen dhe të gjitha detyrimet e Palëve;

vi) Brenda një periudhe 6-mujore nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Blerësi duhet të bëjë një kërkesë për disbursimin e parë. Nëse kërkesa për disbursimin e parë nuk është bërë brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, IDB-ja mund ta përfundojë Marrëveshjen dhe detyrimet e Palëve sipas saj;

vii) Duke llogaritur nga data e miratimit të projektit, data e fundit e tentuar e disbursimit do të jetë 31.12.2010;

viii) Paketa e punëve civile duke përfshirë punimet rrugore, urën dhe strukturat lidhëse do të prokurohen nëpërmjet ofertave konkurruese ndërkombëtare, të kufizuara për vendet anëtare të IDB-së, si dhe udhëzimeve të IDB-së;

ix) Kontratat do të përkufizojnë saktësisht që Qeveria e Shqipërisë (Blerësi/Agjenti po vepron si Agjent i IDB-së në kontratat e dhëna.

x) Shuma e miratuar do të disbursohet në pajtim me kushtet e pagesave të përcaktuara në Kontrata dhe procedurat e disbursimit të IDB-së;

xi) Ndërtimi i rrugës do të përfundojë brenda 3 vjetëve nga data e disbursimit të parë;

xii) Pas përfundimit të ndërtimit, pronësia e punëve të financuara nga IDB-ja do t'i transferohet Qeverisë së Shqipërisë (Blerësi/Agjenti);

xiii) Çmimi i shitjes do t'i paguhet IDB-së brenda 12 vjetëve duke filluar pas periudhës së maturimit prej 3 vjetësh. Pagesat do të kryhen në 24 këste të njëpasnjëshme dhe të barabarta, gjashtë mujore dhe do të paguhen në monedhën e konvertueshme të pranueshme nga IDB-ja;

xiv) Pagesa e parë e çmimit të shitjes do të bëhet 6 muaj pas përfundimit të periudhës së maturimit;

xv) Për llogaritjen e çmimit të shitjes të pagueshëm nga Blerësi/Agjenti, një shtesë prej 5.1% për çdo vit, do t'i shtohet kostos së përgjithshme të shkaktuar nga IDB-ja;

xvi) Të gjitha taksat, detyrimet, pagesat, lidhur me financimin e propozuar të IDB-së do të mbulohen nga Blerësi/Agjenti;

xvii) Blerësi/Agjenti do të mbajë përgjegjësi për të gjitha shpenzimet e pambuluara nga financimi i IDB-së dhe nga rregullimet e këtushme;

xviii) Blerësi/Agjenti merr përsipër të pajisë IDB-në me të gjitha raportet e progresit dhe çdo raport apo informacion të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga IDB-ja.

Huaja

i) IDB-ja do të mundësojë për Qeverinë e Shqipërisë një shumë që nuk e kalon 6.66 milionë ID (përafërsisht e barabartë me 10 milionë USD) për pjesëmarrjen në financimin e ndërtimit të projektit rrugor Durrës–Morinë (Segmenti Kalimash–Rexhepaj);

ii) Huaja do të shlyhet brenda 25 vjetëve duke përfshirë një periudhë shtyrjeje (pa interesa) prej 7 vjetësh dhe do të mbajë një shumë parash taksë shërbimi për të mbuluar shpenzimet aktuale,

duke pasur parasysh që taksa e shërbimit nuk e kalon 2.5% të shumës së huasë, kur llogaritet në bazë vjetore;

iii) Qeveria e Shqipërisë do të mbajë përgjegjësi për të siguruar të gjitha fondet që mund të kërkohen për plotësimin e projektit. Të gjitha shpenzimet e tejkaluara, nëse ka të tilla, do të mbulohen nga Qeveria e Shqipërisë;

iv) Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për projektin do të jenë si më poshtë: i) Ofertat konkurruese ndërkombëtare (ICB) të kufizuara për vendet anëtare të IDB-së (ICB/MC) për punime civile; ii) nëpërmjet listës së konsulentëve më të kualifikuar nga vendet anëtare të IDB-së për shërbimet këshillimore; iii) një listë e firmave lokale më të kualifikuara për kontrollin financiar; iv) blerje në vend për pajisjet IT dhe automjeti që do të blihet për njësinë e menaxhimit të projektit (NJMP);

v) Të gjitha taksat, detyrimet dhe pagesat të lidhura më financimin e propozuar do të mbulohen nga qeveria/përfituesi.

Më lejoni të sigurojë Shkëlqesinë Tuaj për dëshirën e IDB-së për të marrë pjesë në përpjekjet e zhvillimit social–ekonomik që janë ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë.

Me respekt
Dr.Amadou Boubacar Cisse
Zëvendëspresident (Operacionet)
(Firma)

BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
(stema)

SË BASHKU NDËRTOJMË NJË TË ARDHME MË TË MIRË

(PËR DORËZIM)

Nr.Referencës 41/10/ALB Data 12 prill 2007

Drejtuar: **Zyrës së**
Shkëlqesisë së tij Durim Kraja
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Qeveria e Shqipërisë

Lënda : Hua e propozuar dhe financim nga Istisna'a për projektin e rrugës nga Durrësi në Morinë

_____
_

Po bashkëngjisim projektmarrëveshjet në vijim për projektin e përmendur te lënda.

Projektmarrëveshjen Istisna'a
Projektmarrëveshjen e ndërmjetme mes agjencive
Projektmarrëveshjen e huasë.

Ju kërkohet të rishikoni dhe të jepni komente për to nga ana e Qeverisë Shqiptare mbi këto projekt marrëveshje sa më shpejt që të jetë e mundur. Siç është diskutuar edhe nga misioni i IDB-së në Shqipëri (9–16 prill 2007), është planifikuar tashmë që të nënshkruhen Marrëveshjet për financime gjatë punimeve të takimit vjetor të IDB-së që do të mbahet në Dakar, Senegal nga 27 –31 maj 2007.

Me urimet më të mira,

(Firma)
Farrukh Mahmood Mian
Shef sektori (I & FD)
Departamenti i operacioneve në vende – 1

MARRËVESHJA ISTISNA'A
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT KALIMASH – REXHEPAJ SI PJESË E PROJEKTIT TË RRUGËS DURRËS – MORINË,
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJA ISTISNA'A
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Kjo Marrëveshje lidhet në ___/___/____1428H, duke korresponduar ___/___/____2007G ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu quajtur "Blerësi") dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu quajtur "Shitësi").

Për arsye se:

A) Blerësi i ka kërkuar Shitësit të ndërtojë për të segmentin Kalimash-Rexhepaj të projektit të rrugës Durrës–Morinë të përshkruar në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje (që këtu referohet si rruga) për përdorim në projektin e përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje;

B) Shitësi ka rënë dakord të ndërtojë rrugën për Blerësin për një shumë të përgjithshme që të mos i tejkalojë 30 000 000 USD (tridhjetë milionë dollarë amerikanë) vetëm për një çmim shitjeje për t'u vendosur në pajtim me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të paguhen nga Blerësi për Shitësin në 12 vjet pas periudhës së maturimit prej 3 vjetësh, sipas kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje;

C) Kushtet dhe detyrimet e referuara në paragrafin B i janë komunikuar dhe pranuar nga Blerësi, tashmë, rrjedhimisht, Shitësi dhe Blerësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime dhe interpretime

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përshkruar më poshtë:

Marrëveshje e ndërmjetme: Marrëveshja e një date të caktuar ndërmjet Blerësit dhe Shitësit, ku Blerësi do të veprojë si agjent i IDB-së në përzgjedhjen e kontraktuesit dhe supervizimin e ndërtimit të rrugës.

Rruga: Rruga e përshkruar në shtojcën I.

Kostoja kapitale: Kostoja e përgjithshme e ndërtimit të rrugës që përfshin çmimin që do t'i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës, si dhe çdo kosto dhe shpenzim tjetër të bërë nga Shitësi për ose

në lidhje më ndërtimin e rrugës.

Kontratë: Kontrata për ndërtimin e rrugës, e përfunduar në emër të Shitësit nga Blerësi me Kontraktuesin.

Kontraktuesi: Kontraktuesi të cilit do t'i besohet ndërtimi i rrugës.

Data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes: Datë në të cilën Shitësi e deklaron Marrëveshjen efektive në pajtim me nenin 13.

Periudha e maturimit: Periudha që fillon me datën e disbursimit të parë dhe mbaron pas 36 muajsh.

Dinari islamik dhe "ID": Njësia e llogarisë për Shitësin, e përcaktuar në pajtim me nenin 4 (1) të neneve të Marrëveshjes së Shitësit, 1 dinar islamik është i barabartë me një të drejtë të veçantë nxjerrjeje të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Projekti: Projekti i përshkruar në shtojcën II.

Çmimi i shitjes: Çmimi i shitjes së rrugës, i pagueshëm nga Blerësi për Shitësin në pajtim me nenin 9.

Taksat: Çdo taksë, tatim apo çdo lloj vendosje detyrimesh të një natyre të ngjashme (duke përfshirë pa kufizime çdo gjobë që është e pagueshme në lidhje me çdo dështim për të paguar ose vonesë në pagesën e çdonjërës prej tyre).

Dollarë amerikanë dhe "US$" Monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.2 Në këtë Marrëveshje

a) Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët e shënuara në njëjës përfshijnë dhe shumësin dhe anasjellas, fjalët që tregojnë personat përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referencat për një shtojcë të veçantë, bashkëlidhje, nen apo seksion është një referencë për atë shtojcë, bashkëlidhje, nen apo seksion të kësaj Marrëveshjeje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e ndërmjetme dhe të papërcaktuara këtu do të kenë të njëjtin kuptim të dhënë në Marrëveshjen e ndërmjetme.

c) Titujt e neneve dhe seksioneve janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të përdoren për të përcaktuar, interpretuar ose kufizuar ndonjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Preambula dhe shtojcat, pjesë të Marrëveshjes

Preambula dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë përbërëse.

Neni 3

Ndërtimi i rrugës

3.1 Shitësi bie dakord të ndërtojë rrugën në pajtim me kushtet dhe parashikimet e kësaj Marrëveshjeje dhe Blerësi bie dakord të marrë në dorëzim rrugën sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe të paguajë çmimin e shitjes.

3.2 Për shmangien e çdo dyshimi, Blerësi bie dakord që Shitësi të ndërtojë rrugën nëpërmjet një Kontraktuesi që duhet përcaktuar në pajtim më Marrëveshjen e ndërmjetme.

Neni 4

Koha për përfundimin e rrugës

Duke qenë subjekt i neneve 6 dhe 10, ndërtimi i rrugës do të përfundojë brenda tre vjetëve nga data e disbursimit të parë.

Neni 5

Përfundimi i Marrëveshjes

5.1 Duke qenë subjekt i seksionit 13.2, Blerësi mund t'i kërkojë Shitësit ta përfundojë këtë Marrëveshje dhe të anulojë shumën e miratuar ose çdo pjesë të saj, në çdo kohë para nënshkrimit të Marrëveshjes këshillimore ose kontratës.

5.2 Vetëm nëse disbursimi është bërë nga shuma e miratuar përpara përfundimit, nëse shuma e

miratuar është anuluar sipas nenit 12, Marrëveshja do të vlerësohet automatikisht si e përfunduar.

5.3 Përpara nënshkrimit të marrëveshjes kështillimore ose kontratës, Shitësi, duke njoftuar Blerësin, mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në rastet e mëposhtme:

a) Dështimi i Blerësit për të përmbushur detyrimet e tij për të paguar çdo shumë që i detyrohet Shitësit ose ndonjë organi të atashuar pranë Shitësit, sipas çdo marrëveshjeje, përveç kësaj Marrëveshjeje;

b) Një situatë e jashtëzakonshme ka ndodhur, e cila: i) e bën të pamundur, sipas opinionit të Shitësit, që Blerësi të plotësojë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose ii) që parandalon arritjen e qëllimeve për të cilat kjo Marrëveshje është krijuar;

c) Një prezantim i bërë nga Blerësi ose sjellja e një qëndrimi dhe me synimin që të mbështetet nga Shitësi në vazhdimin e projektit për miratim ose për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë qenë jo i plotë ose jo korrekt, në lidhje me ndonjë material.

Marrëveshja do të vazhdojë të jetë e përfunduar deri në rastin ose rastet, që kanë qenë shkak për këtë përfundim, të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Shitësi ta ketë njoftuar Blerësin që sipërmarrja e Shitësit për ta ndërtuar rrugën është rivendosur, cilido që është më herët; pajisur gjithsesi, që në rastin e një njoftimi të tillë rivendosjeje, sipërmarrja për të ndërtuar rrugën do të ndërmerret vetëm në masën dhe duke iu nënshtruar kushteve të specifikuara në një njoftim të tillë dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të cenojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose përmirësim të Shitësit në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër apo vijuese, përshkruar në këtë seksion.

5.4 As Shitësi dhe as Blerësi nuk do të kenë detyrime të mëtejshme ndaj njëri-tjetrit që nga data e përfundimit të Marrëveshjes, sipas seksioneve 5.1, 5.2 apo 5.3 të këtij neni, duke provuar se përfundime të tilla nuk do të cenojnë ndonjë detyrim të ndodhur apo të drejtë që i rrjedh çdo pale përpara një përfundimi të tillë.

5.5 Duke mos i qëndruar përfundimeve të Marrëveshjes, Blerësi duhet të vazhdojë të bashkëpunojë dhe ta asistojë Shitësin në rikuperimin nga Kontraktuesi të asaj pjese të çmimit të kontratës dhe të çdo shume që mund të jetë disbursuar nga Shitësi përpara përfundimit të kontratës.

Neni 6

Pranimi i rrugës nga Blerësi

Blerësi do të jetë i detyruar të pranojë në mënyrë të parevokueshme rrugën për të gjitha qëllimet, kur Blerësi firmos certifikatën përfundimtare të pranimit.

Neni 7

Pronësia dhe risku

Titulli dhe rreziku në rrugë do t'i kalojë Blerësit pas firmosjes së certifikatës përfundimtare të pranimit.

Neni 8

Kushtet e rrugës

8.1 Pa cenuar sa më sipër, Shitësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ose detyrim ndaj Blerësit ose ndonjë personi tjetër, ose enti përsa i përket:

a) çdo detyrim, humbje ose dëmtim i shkaktuar (ose që mund të jetë shkaktuar) direkt ose indirekt nga rruga, ose nga ndonjë papërputhshmëri, pamjaftueshmëri ose defekt, apo nga rrethana të tjera në lidhje me këtë;

b) përsa i përket përdorimit apo operimit të rrugës, ose çdo rreziku që lidhet me të;

c) çdo ndërprerjeje të shërbimit, humbjeje të biznesit ose përfitim i paraprirë apo dëmtime të vazhdueshme.

8.2 Shitësi merr përsipër t'i japë Blerësit përfitimin e çdo garancie, kushti, autorizimi që lidhet me rrugën dhe që mund t'i jetë dhënë nga Kontraktuesi Shitësit dhe i cili është analizuar dhe pranuar nga Blerësi, si dhe të gjitha kushtet e tjera dhe të drejtat e parashikuara nga ligji ose të njohura nga e drejta zakonore në favor të Shitësit. Veç kësaj, Shitësi do të ndërmarrë çdo veprim tjetër, nëse Blerësi do ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme t'i bëhet e mundur Blerësit të ankohet ndaj Kontraktuesit.

Neni 9

Pagesa e çmimit të shitjes

9.1 Çmimi i shitjes do të jetë ID 23 678 280. Ky çmim i shitjes do të rishikohet në bazë të kostos kapitale të rrugës plus një shumë shtesë prej 5.1% (pesë pikë një për qind) çdo vit dhe do të njoftohet Blerësi menjëherë pas përfundimit të periudhës së maturimit.

9.2 Blerësi do ta paguajë çmimin e shitjes në njëzet e katër (24) këste të vazhdueshme gjashtëmujore, i pari prej të cilëve bëhet i vlefshëm dhe i pagueshëm gjashtë muaj pas mbarimit të periudhës së maturimit. Shitësi do t'i dërgojë tabelën e pagesës së çmimit të shitjes Blerësit menjëherë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit.

9.3 Duke qenë subjekt i seksionit 9.7 të këtij neni, çdo pagesë që duhet bërë nga Blerësi për Shitësin do të bëhet në një monedhë të konvertueshme, të pranueshme nga Shitësi me vlerë në datën e vendosur në llogarinë e Shitësit ose në çdo mënyrë tjetër, sipas njoftimit me shkrim që Shitësi herë pas here mund t'i bëjë Blerësit.

9.4 Çdo pagesë do të konsiderohet të jetë kryer, kur ndonjë prej bankave të mëposhtme i konfirmon Shitësit faturën e një pagese të tillë në llogarinë e Shitësit:

a) Nëse një pagesë bëhet në dollarë amerikanë:
Nr. i llogarisë: GB14 GULF 4053 0700 1591 11
Gulf International Bank B.S.C.
One Knightsbridge
London SWIX 7XS
United Kingdom
Swift Code: GULFGB2L.

b) Nëse një pagesë bëhet në stërlina:
Nr. i llogarisë: 122432 GBP 2520 01
Gulf International Bank B.S.C.
One Knightsbridge
London SWIX 7XS
United Kingdom
Nr: telex 8812889/8813326 GIBANK G
Swift Code: GULFGB2L.

c) Nëse një pagesë bëhet në euro:
Nr. i llogarisë: 096965 001 51
Union De Banques Arabes Et Francaises (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex, France
Nr: Telex 610334 UBAF
Swift Code: UBAFRPPXXX

9.5 Nëse një pagesë bie në një ditë që nuk është ditë pune, pagesa do të kryhet në ditën tjetër pasardhëse të punës.

9.6 Dinari islamik është njësia e llogarisë për secilën dhe çdo shumë, në çdo kohë që duhet të paguhet nga Blerësi, siç është nënvizuar. Nëse për qëllim të kësaj Marrëveshjeje është e nevojshme të konvertohet ndonjë shumë në dinarë islamikë kundrejt çdo monedhe tjetër apo anasjellas, norma e aplikuar e kursit të këmbimit do të vendoset nga Shitësi. Shitësi normalisht do të bëjë konvertimin në bazë të normës mbizotëruese të këmbimit valutor për të drejtën e veçantë të tërheqjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe siç është këshilluar nga FMN-ja, në ditën në të cilën një pagesë e tillë është bërë.

9.7 Të gjitha pagesat e bëra nga Blerësi do të bëhen të lira dhe të pastra dhe pa deduksion ose në llogari të çdo takse, dërgese, kundërkërkese etj. Nëse Blerësi është i detyruar me ligj të bëjë ndonjë zbritje ose refuzim nga ndonjë shumë e paguar prej tij, shuma e pagueshme prej tij, në pajtim me të cilën një zbritje apo refuzim i tillë është kërkuar të bëhet, do të rritet në masën e nevojshme për të siguruar që pas bërjes së një zbritjeje apo refuzimi, Shitësi merr dhe mban (pa pasur asnjë detyrim ndaj

ndonjë zbritjeje apo refuzimi) një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë në rast të mos pasjes së zbritjeve ose refuzimeve.

Neni 10
Përfaqësimet

Blerësi parashtron që:

1. Ka kompetencë për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe të plotësojë detyrimet e tij, si dhe të gjitha veprimet e kërkuara për autorizimin, ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe performanca nga Blerësi e detyrimeve të tij është bërë në kohë;

2. Detyrimet e shprehura për t'u arritur nga Blerësi në këtë Marrëveshje janë detyrime ligjore dhe të vlefshme detyruese mbi Blerësin, në pajtim me termat e këtij dokumenti;

3. Ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe performanca e Blerësit ndaj detyrimeve të tij nuk përbën dhe nuk do të rezultojë në ndonjë shkelje të ndonjë marrëveshjeje, traktati ose ligji;

4. Të gjitha aktet, kushtet dhe gjërat (duke përfshirë miratimin e kontrollit të këmbimit) të kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, duhen kryer dhe përmbushur me qëllim që:

i) të lejojë Blerësin që të hyjë ligjërisht dhe t'i zbatojë detyrimet e shprehura për t'u përmbushur në këtë Marrëveshje;

ii) të sigurojë që detyrimet e shprehura për t'u përmbushur në këtë Marrëveshje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të detyrueshme; dhe

iii) ta bëjë këtë Marrëveshje të pranueshme qartë në Republikën e Shqipërisë, pa hapa ose formalitete të tjera të bëra, të plotësuara në pajtim të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

5. Të mos ketë filluar apo kërcënuar asnjë veprim apo procedim administrativ prej ose përpara çdo gjykate, apo agjencie, e cila mund të ketë efekt të pafavorshëm material mbi kushtet financiare të Blerësit;

6. Sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi që prej kësaj date, pretendimet e Shitësit ndaj Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të renditen së paku *pari passu* (në mënyrë të barabartë) me pretendimet e kreditorëve të tjerë të pasiguruar për ndonjë borxh të Blerësit.

Neni 11
Rastet e mosplotësimit

11.1 Në rast se një prej këtyre ngjarjeve të përcaktuara në këtë seksion do të ketë ndodhur dhe të jetë në vazhdim, atëherë Shitësi, duke njoftuar Blerësin, mund ta deklarojë një pjesë apo i gjithë çmimi i shitjes të jetë dhe të bëhet menjëherë i detyrueshëm dhe i pagueshëm (pavarësisht nga çdo gjë në këtë Marrëveshje) pa një njoftim të mëtejshëm:

a) mosplotësimi do të ketë ndodhur në pagesën e ndonjë prej kësteve të çmimit të shitjes dhe ky mosplotësim të ketë vazhduar për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) ditore;

b) mosplotësimi (përveç mosplotësimit të përcaktuar në pikën (a) më sipër) do të ketë ndodhur në plotësimin e ndonjë detyrimi të Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe një mosplotësim i tillë të ketë vazhduar për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore;

c) çdo përfaqësim ose autorizim i konfirmuar ose i bërë nga Blerësi në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje, ose në lidhje me çdo kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të vlerësohet të jetë jokorrekt dhe do të vazhdojë të jetë jokorrekt për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i dhënë Blerësit nga Shitësi;

d) Blerësi duhet të ketë organizuar një mbledhje ose të ketë ndërmarrë çdo veprim, me qëllim rregullimin dhe hartimin me kreditorët e tij;

e) Blerësi do ta ketë ndërprerë ose do ta ketë kërcënuar për ta ndërprerë për ndonjë arsye zbatimin e biznesit ose të çdo pjesë të rëndësishme të saj;

f) Blerësi nuk do të ketë mundësi të paguajë borxhin e tij, kur ato bëhen të detyruara ose Blerësi të ketë falimentuar; ose çdo mbajtës i garancisë do të ketë marrë në posedim ligjërisht, ose një marrës, ose një i besuar do të ketë përcaktuar për një pjesë, ose të gjithë sipërmarrjen ose asetet e Blerësit; apo një lënie peng, apo një ekzekutim (ose një proces analog) do të jetë vënë për sekuestrim ose të jetë në fuqi ose të jetë lëshuar kundër çdo pasurie të luajtshme, ose prone të Blerësit dhe në një

lënie pengu të tillë apo ekzekutimi, nuk do të jetë përmbushur brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve; ose një urdhër është bërë ose një zgjidhje efektive ka kaluar ose procedura analoge të ndërmarra për përfundimin e Blerësit, falimentimin ose shpërndarjen ose ndonjë ngjarje tjetër do të ketë ndodhur dhe sipas çdo ligji të zbatueshëm do të ketë një efekt të ngjashëm për çdonjë nga ngjarjet e listuara më sipër në këtë paragraf;

g) çdo parashikim i kësaj Marrëveshjeje ose i garancisë është ose bëhet jo i vlefshëm, jo i ligjshëm, ose i pazbatueshëm.

11.2 Nëse çdo rast të mosplotësimit ose çdo rast që me kalimin e kohës, ose njoftimin dhe kalimin e kohës do të bëhej një rast i mosplotësimit të ndodhur, Blerësi do t'i japë menjëherë Shitësit njoftim për këtë, me teleks ose faksimile, duke specifikuar natyrën e këtij rasti të mosplotësimit, si dhe për hapat që Blerësi po ndërmerr për të përmirësuar situatën.

11.3 Asnjë zhvillim sjelljeje dhe asnjë vonesë në zbatimin ose heqjen e zbatimit, e çdo të drejte, kompetence ose përmirësimi që rrjedh prej Shitësit në bazë të mosplotësimit sipas kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë marrëveshjeje tjetër do të cenojë çdo të drejtë, kompetencë ose përmirësim të tillë, të interpretohet si heqje dorë prej saj ose si një pranim i heshtur as veprimi i Shitësit në përputhje me një mosplotësim të tillë, ose çdo pranim në heshtje prej tij aty, do të cenojë ose dëmtojë çdo të drejtë, kompetencë ose përmirësim të Shitësit në përputhje me çdo mosplotësim tjetër.

Neni 12
Anulimi i shumës së miratuar

12.1 Nëse kontrata nuk është firmosur brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi duke njoftuar Blerësin mund ta anulojë shumën e miratuar, përveç rastit kur është i bindur nga justifikimi i Blerësit për një vonesë të tillë.

12.2 Në rastin, kur Kontraktuesi nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kontratës dhe Blerësi në konsultim me Shitësin përfundon kontratën në pajtim me kushtet e saj, një mbarim i tillë 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas mbarimit do të operojë si anulim i çdo shume të mbetur pa disbursuar nga shuma e miratuar, përveç rastit kur Shitësi bie dakord ndryshe.

Neni 13
Efektshmëria e Marrëveshjes

13.1 Kjo Marrëveshje nuk do të bëhet efektive deri sa Blerësi ta informojë Shitësin me një opinion ligjor nga këshilltari ligjor për Blerësin, kryesisht në formën e përcaktuar në shtojcën III;

13.2 Nëse Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në zbatim brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e firmosjes, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e Palëve do të përfundojnë, përveç rastit kur Shitësi pasi merr në konsideratë shkaqet e vonesës, do të vendosë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Shitësi, sipas rastit, do ta njoftojë menjëherë Blerësin për këtë datë të mëvonshme ose për përfundimin e Marrëveshjes.

Neni 14
Heqja dorë

Dështimi i Shitësit për të ushtruar apo mbrojtur çdonjë nga të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesat apo dështimet për të ushtruar apo mbrojtur çdo përmirësim që mund të ketë përkundrejt Blerësit, nuk do ta cenojë këtë të drejtë, ose këtë përmirësim dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose përmirësim.

Neni 15
Ligji rregullues, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

15.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe do të interpretohet në pajtim me Sherihatin Islamik.

15.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve për këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim i njërës Palë përkundrej Palës tjetër që vjen sipas kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk mund të zgjidhet miqësisht nga Palët brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të njërës Palë për tjetrën, do t'i

nënshtrohet arbitrimit nga një Gjykatë Arbitrazhi, siç përcaktohet më poshtë:

a) Palët e një arbitrimi të tillë do të jenë Shitësi në njërën anë dhe Blerësi në anën tjetër.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar, si më poshtë: një gjyqtar do të emërohet nga Shitësi, gjyqtari i dytë nga Blerësi dhe gjyqtari i tretë (që këtu do të referohet si "Gjyqtari i Arbitrazhit") do të vendoset me marrëveshje të Palëve ose nëse ato nuk bien dakord nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Konferencës Islamike (OIC). Gjyqtari i arbitrazhit do të jetë një jurist i specializuar në financë ndërkombëtare ose një bankier me njohuri mbi transaksionet financiare islamike. Nëse secila Palë nuk emëron një gjyqtar, ky gjyqtar do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OIC-it. Në rast se një gjyqtar i emëruar në pajtim me këtë seksion do të japë dorëheqjen, vdesë ose do të bëhet i pazoti të veprojë, gjyqtari zëvendësues do të emërohet në të njëjtën mënyrë siç është parashikuar për emërimin e gjyqtarit fillestar si dhe ky zëvendësues do t'i ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e gjyqtarit fillestar.

c) Procedurat e arbitrimit mund të krijohen sipas këtij seksioni përmes njoftimit nga njëra Palë, duke vendosur këto procedime për Palën tjetër. Një njoftim i tillë do të përmbajë një deklarim që përcakton natyrën e konfliktit ose pretendimin që çohet për arbitrim, natyrën e lehtësirave të kërkuara, emrin e gjyqtarit të përcaktuar nga Pala, duke kërkuar procedimet dhe emrin e një gjyqtari arbitrazhi të propozuar. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dhënia e një njoftimi të tillë, Pala tjetër do të njoftojë për emrin e gjyqtarit të përcaktuar nga kjo Palë, si dhe miratimin ose jo të përcaktimit të gjyqtari të arbitrazhit të propozuar.

d) Nëse brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas dhënies së një njoftimi të tillë që vendos procedurat e arbitrimit, Palët nuk kanë rënë dakord për një gjyqtar arbitrazhi ose Pala për të cilën është dhënë njoftimi i arbitrimit nuk emëron një gjyqtar, çdo Palë mund të kërkojë emërimin e një gjyqtari të dytë ose gjyqtari arbitrazhi (sipas rastit), sipas parashikimi të paragrafit (b) të këtij seksioni.

e) Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën dhe vendin e përcaktuar nga gjyqtari i arbitrazhit. Pas kësaj, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë ku dhe kur do të mblidhet.

f) Duke qenë subjekt i parashikimeve të këtij seksioni dhe duke përjashtuar rastet, kur Palët bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha problemet që i përkasin kompetencës së saj dhe do të vendosë procedurën e saj. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit duhet të jenë me shumicë votash.

g) Gjykata e Arbitrazhit do t'u ofrojë të gjitha Palëve një dëgjim të ndershëm dhe do ta japë vendimin e saj me shkrim. Një vendim i firmosur nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit përbën vendimin e kësaj Gjykate. Një kopje e firmosur e vendimit do t'i jepet secilës Palë. Çdo vendim i dhënë në pajtim me parashikimet e këtij seksioni do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët e kësaj Marrëveshjeje. Secila Palë do të pajtohet me çdo vendim të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit në pajtime më parashikimet e këtij seksioni.

h) Palët do të vendosin shumën e pagesës së gjyqtarëve, si dhe të personave të tjerë që do të nevojiten për zhvillimin e procedurave të arbitrimit. Nëse Palët nuk bien dakord për këto shuma përpara mbledhjes së Gjykatës së Arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë për këto shuma në mënyrë të arsyeshme sipas rrethanave. Shitësi dhe Blerësi do të paguajnë shpenzimet e tyre për procedurat e arbitrimit. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen dhe përballohen në mënyrë të barabartë midis Shitësit dhe Blerësit. Çdo paqartësi, përsa i përket ndarjes së shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose të procedurës së pagesave të këtyre shpenzimeve do të përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

i) Parashikimet për arbitrimin, të vendosura në këtë seksion, do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve midis Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose të çdo pretendimi nga çdo Palë përkundrejt Palës tjetër që evidentohen nga kjo Marrëveshje.

j) Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pasi kopje të vendimit u janë shpërndarë Palëve dhe nëse një prej Palëve nuk i bindet vendimit të dhënë, atëherë Pala tjetër mund të kërkojë gjykim ose të nisë procedime për të zbatuar vendimin në çdo gjykatë ose juridiksion kompetent kundër Palës tjetër, mund të vendosë këtë vendim me zbatim, ose mund të vendosë një përmirësim të përshtatshëm kundër Palës tjetër për marrjen e vendimit ose parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje.

k) Shërbimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me procedimet sipas këtij seksioni ose në lidhje me çdo procedim për marrjen e vendimeve të dhëna në pajtim me këtë seksion, mund të bëhen në mënyrën e parashikuar në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje. Palët e kësaj Marrëveshjeje heqin dorë prej të gjitha kërkesave të tjera për dërgimin e çdo njoftimi të tillë.

Neni 16
Njoftimet

16.1 Çdo njoftim ose kërkesë për t'u dhënë apo për t'u bërë nga njëra Palë për tjetrën, sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me të, do të jetë me shkrim dhe mund të jepet me teleks ose letër. Një njoftim i tillë ose kërkesë do të vlerësohet të jetë dhënë siç duhet, kur të dorëzohet dorazi ose me postë ose me teleks ose me telefaks për Palën tjetër në adresat e tyre të specifikuara në seksionin 16.2 ose në ndonjë adresë tjetër të përcaktuar me njoftim për Palën tjetër.

16.2 Për qëllimet e seksionit 16.1, Palët kanë dhënë adresat e tyre, si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Blerësi):
Ministri i Financave
Blv: "Dëshmorët e Kombit", Nr 1
Tirana, Albania
Tel: ++ (355-4) 228-405
Faks: ++ (355-4) 228-494
Për Bankën Islamike për Zhvillim (Shitësi)
Kutia Postare: 5925
Jeddah- 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601137 ISDB SJ
Telegraf: BANKISLAMI JEDDAH
Tel: +699 2 6361400
Faks: +966 2 6366871

FAQE ZBATIMI

Në dëshmi të sa më sipër, Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përmendur në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCA I
PËRSHKRIMI I RRUGËS

Rruga që konsiston në variantin me 4 korsi 2X(2X3.75 metra + 2X1.5 metra), duke përdorur barrierën Nju Xhersi fillon afër liqenit të vogël në Kolsh dhe zbret përgjatë shpateve jugore të zonës, duke devijuar nga ura ekzistuese në Kolsh dhe kërkon ndërtimin e një ure-rrugë të re me gjatësi 240 m. Më pas, rruga vazhdon përgjatë shpatit deri sa arrin fshatin Myc. Më pas kalon lumin duke përdorur urën-rrugë me gjatësi 240 m dhe lartësi 45 m. Në km 5+400 ka përsëri një urë-rrugë me gjatësi 120 m. Rruga mbaron në linjën ekzistuese të asfaltit. Urat e sipërme propozohen të kenë gjatësi të krahëve prej 30 ose 40 metrash. Strukturat kryesore janë 10 urë-rrugë me një gjatësi të përgjithshme prej 800m.

SHTOJCA II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Synimi kryesor i projektit është që të sigurojë një rrjedhë të pandërprerë të trafikut, të pakësojë kostot e operimit të automjeteve dhe aksidentet rrugore, të kursejë kohën e udhëtimit dhe të sjellë një përmirësim të përgjithshëm ekonomik në zonën e projektit, përmes një mundësie të rritur hyrjeje dhe lëvizshmërie më të madhe për në zonat rurale. Projekti, gjithashtu do të përshpejtojë hyrjen drejt zonave bregdetare dhe në terrenin malor mbresëlënës, si dhe në zonat fshatare përtej Kukësit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me vendin fqinjë, Kosovën. Projekti përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. Punimet civile

(Punimet civile për seksionin e rrugës Kalimash–Rexhepaj (5.6 kilometra), rrugë me katër korsi (secila 3.75 metra e gjerë) dhe me dy bankina (secila 1,5 metra e gjerë);

2. Shërbimet e këshillimit (rishikim i projektit të detajuar dhe supervizionit);

3. Njësia e menaxhimit të projektit (PMU);

4. Kontrolli financiar;

5. Seminari i fillimit dhe vizita familjarizimi në selinë e IDB-së;

6. Kontingjencat fizike dhe të çmimeve.

SHTOJCA III
FORMA E OPINIONIT TË KËSHILLTARIT PËR BLERËSIN

Datë____/___/____

Për:

Bankën Islamike për Zhvillim
Kutia Postare: 5925 JEDDAH 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite

Të nderuar Zotërinj,

Në cilësinë time si Këshilltar i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Blerësi), kam shqyrtuar origjinalet (ose kopjet) të vërtetuara ose të identifikuara si Marrëveshja Istisna'a dhe Marrëveshjen e ndërmjetme (Marrëveshjet) të datës ___/___/____ që parashikon ndërtimin nga Banka Islamike e Zhvillimit (Shitësi) të segmentit rrugor Kalimash–Rexhepaj, të projektit rrugor Durrës – Morinë (Rruga) për Blerësin, në një shumë prej 30 000 000 USD, dhe duke emëruar Blerësin si agjentin e Shitësit për supervizimin e ndërtimit të rrugës dhe çdo dokument tjetër që e kam çmuar të nevojshëm ose të përshtatshëm në bazë të opinioneve të shprehura këtu.

Opinionet e shprehura këtu kufizohen në çështjet që ngrihen sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe nënndarjeve të tyre politike dhe unë nuk kam qëllim të shpreh një opinion mbi ndonjë çështje që ngrihet sipas ligjit të ndonjë juridiksioni tjetër.

Të gjithë termat e përcaktuar në Marrëveshje dhe të përdorur, por jo të përcaktuar këtu kanë kuptimet e dhëna për to në këtë Marrëveshje.

Opinioni im është që:

a) Blerësi është organizuar në kohë dhe ekziston në mënyrë të vlefshme sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ka fuqinë dhe autoritetin të ketë në zotërim pronën e tij, të zhvillojë biznesin e tij dhe të konsumojë transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

b) Blerësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin dhe dërgimin e Marrëveshjeve dhe të gjitha dokumentet e tjera për t'u ekzekutuar dhe dërguar në lidhje me Marrëveshjen, performancën e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjeve dhe konsumimin e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshje.

c) Marrëveshjet janë ekzekutuar në kohë dhe janë dërguar nga Blerësi dhe përbëjnë detyrime të ligjshme dhe të vlefshme të Blerësit dhe që vendosen ndaj Blerësit, në pajtim me kushtet e tyre, duke qenë subjekt i paaftësisë së zbatueshme për të paguar, moratoriumi apo ligjeve të ngjashme që prekin përgjithësisht të drejtat e kreditorëve.

d) Të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet e çdo lloji, të nevojshme për t'u autorizuar ose për të kërkuar vlefshmërinë dhe vendosjen e detyrimeve të parashikuara sipas këtyre Marrëveshjeve përkundrejt Blerësit, janë përftuar dhe janë të vlefshme me fuqi dhe efekt të plotë.

e) Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur dhe po vazhdon që përbën, ose që me dhënien e njoftimit ose me mbarimin e kohës, ose të të dyjave, mund të përbëjë një mosplotësim sipas çdo marrëveshjeje ose instrumenti që evidenton çdo detyrim të Blerësit dhe asnjë ngjarje nuk do të ndodhë përgjatë kryerjes së disbursimit sipas Marrëveshjes.

f) Çdo kreditori të Blerësit nuk i kërkohet miratim apo njoftim sipas kushteve të ndonjë Marrëveshjeje ose instrumenti që evidenton të gjitha detyrimet e Blerësit për ekzekutimin dhe dorëzimin, ose të performancës së detyrimeve të blerësit sipas Marrëveshjeve, ose konsumimin e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshjet. Ky ekzekutim, dorëzim, performancë apo kosumim nuk do të rezultojë me ndonjë shkelje, ose të përbëjë një kundërvajtje sipas kapitujve ose akteve nënligjore të blerësit ose çdo

marrëveshjeje, instrumenti, vendimi apo urdhri të njohur prej meje, apo çdo statuti, rregulli apo rregulloreje të zbatueshme për Blerësin apo për një pjesë të pronës së tij.

g) Nuk ka veprime apo procedime të mbetura pezull apo sipas dijenisë sime, të kërcënuara me vendime të pafavorshme, të cilat mund të kenë një efekt të kundërt material mbi situatën financiare të Blerësit apo të cenojnë aftësinë e Blerësit për të zbatuar detyrimet e tij apo të prekë vlefshmërinë apo detyrueshmërinë e Marrëveshjeve.

h) Blerësi gëzon autoritet të plotë mbi pronën e tij në mënyrë të lirë dhe të pastër nga çdo detyrim garancie apo barra të tjera dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes renditen të paktën njësoj me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara.

i) Ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjeve nuk janë subjekt i ndonjë takse, detyrimi apo gjobe, duke përfshirë pa kufizim çdo regjistrim apo taksë transferimi, detyrime vule apo detyrime të ngjashme të vendosura nga ose brenda Republikës së Shqipërisë ose ndonjë nënndarje politike ose ndonjë autoriteti taksues, këtu dhe prej kësaj.

j) As Blerësi, as prona e tij nuk kanë të drejtën e imunitetit mbi bazat e sovranitetit ose përndryshe nga juridiksioni, bashkëngjitur (para ose pas vendimit) apo ekzekutim në lidhje me çdo veprim apo procedim që lidhet në një farë mënyre me marrëveshjen që mund të paraqitet në gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

k) Ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes nga Blerësi dhe performanca e detyrimeve të tij sipas saj është në themel të transaksioneve financiare.

l) Zgjedhja nga Palët për Marrëveshjet e Sherihatit Islamik si ligj zbatues është i ligjshëm, i vlefshëm dhe detyrues.

m) Nuk është e nevojshme të sigurohet që ligjshmëria, vlefshmëria, detyrueshmëria apo pranueshmëria të paraqiten në gjykatat e Republikës së Shqipërisë të marrëveshjeve që ato të ruhen, regjistrohen në çfarëdo lloj gjykate apo agjencie qeveritare të Republikës së Shqipërisë ose të vulosen më ndonjë vulë apo taksë të ngjashme transaksioni.

n) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me qëllim që të bëjë të mundur që Shitësi të vendosë të drejtat e tij sipas marrëveshjeve ose me arsyen e ekzekutimit të marrëveshjeve apo performancës së shitësit për detyrimet e tij, që Shitësi të jetë i licencuar, i kualifikuar apo i autorizuar të zhvillojë biznes në Republikën e Shqipërisë.

o) Shitësi nuk parashikohet të jetë rezident, me seli të përhershme për të zhvilluar biznes apo subjekt i taksimit në Republikën e Shqipërisë vetëm për arsye të ekzekutimit, performancës dhe/ose zbatimit të marrëveshjeve, ndërtimin e rrugës nga Shitësi dhe shitjen e saj Blerësit sipas marrëveshjeve, dhe nuk do të vendosen taksa në çdo shumë që mund të merret nga Shitësi sipas marrëveshjeve.

Derisa dhe vetëm në qoftë se i jap Shitësit njoftim për ndonjë ndryshim në këtë opinion përpara disbursimit të fondeve sipas Marrëveshjes, ju dhe këshilltari juaj mund të mbështeteni në këtë opinion në çdo kohë që prej kësaj date dhe duke përfshirë një disbursim të tillë, ashtu sikurse ky opinion u datua në fillim dhe në mbarim, dhe dorëzuar, në çdo kohë të tillë.

Me respekt